

*Pyetjet e pranuar përmes e-mail-it dhe përgjigjet e tyre*

Nr.	Pyetja	Përgjigja
1.	A duhet medoemos dorëzuar/parapare aktivitete në nivel rajonal?	Sipas Udhëzuesit tek Kushtet e Zbatimit të aktiviteteve parashihet që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që projekti të respektojë parimet e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit.</li> <li>• Aktivitetet duhet të zhvillohen në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.</li> </ul> Si dhe, duhet të specifikohet se në cilin rajon zhvillimor realizohen aktivitetet.
2.	Sa duhet paraparë pagat e stafit të rregullt?	Pagat e stafit përcaktohen nga aplikuesi.
3.	A mbulohen shpenzimet e mirëmbajtjes së xhirollogarisë dhe transfereve bankare?	Jo.
4.	Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të publikuara, nuk kemi vërejtur ndonjë përcaktim të qartë mbi kohëzgjatjen e implementimit të projekteve.	Sipas Udhëzuesit tek Faza e Implementimit parashihet që: Afati i implementimit të projektit do të specifikohet në Kontratë.
5.	Cila është periudha e saktë e implementimit të projektit (kohëzgjatja)?	Sipas Udhëzuesit tek Faza e Implementimit parashihet që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Afati i implementimit të projektit do të specifikohet në Kontratë.</li> </ul>
6.	A është e detyrueshme të aplikojmë në partneritet?	Jo, nuk është e detyrueshme.
7.	Nëse po aplikojmë në partneritet, a duhet domosdoshmërisht që partneri të jetë OJQ apo mund të jetë edhe subjekt afarist (biznes)?	Po, duhet të jetë OJQ. Partneriteti me subjekte afariste (biznese) lidhet vetëm për ofrimin e shërbimeve që ato japin gjatë implementimit të projektit.
8.	Ne si OJQ nuk kemi ende tre (3) vite nga themelimi, por partneri ynë (qoftë OJQ apo biznes) është themeluar më shumë se tre vite më parë. A mund të aplikojmë si bartës kryesor të projektit, apo duhet që partneri të jetë lider i projektit?	OJQ aplikuese duhet të jetë liderë e projektit dhe të kujdeset që të përmbushen kriteret e parapara.
9.	A kërkohet që konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të OJQ-së të jetë origjinal, apo është e pranueshme edhe kopja e skanuar?	Sipas Udhëzuesit tek Dokumentacioni shtesë parashihet që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të OJQ-së (i cili duhet të jetë nxjerrë gjatë periudhës kur thirrja publike është ende e hapur).</li> </ul>

10.	A është e pranueshme që projekti të implementohet vetëm në një rajon të Kosovës apo është e domosdoshme që të përfshihen më shumë rajone?	Jo, nuk është e domosdoshme me shumë rajone.
11.	A janë të pranueshme për aplikim klubet sportive me projekte të tilla si: Trajtime për vajza në sport dhe lidërsnip, që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik përmes përfshirjes së të rinjve dhe grave?	Jo.
12.	Tek seksioni "I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN DHE PARTNERËT", në pikën 18. Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së - a duhet të përshkruajmë objektivat tona statutoe apo objektivat e thirrjes që synojmë me këtë projekt?	Tek pika 18 e seksionit I-rë duhen të përshkruhen objektivat statutoe të OJQ-së ndërsa tek pika 9 e seksionit II-të duhet të përshkruhet objektivi i thirrjes.
13.	Tek seksioni "II. INFORMACION MBI PROJEKTIN", në pikën 26. A është kryer projekti në partneritet? - a i referohet projektit që do të aplikojmë apo projekteve të mëhershme që kemi implementuar?	Pyetja i referohet projekteve që janë realizuar.
14.	Në pikën 27. Përshkruani rolin/kontributin e organizatave partnere në zbatimin e projektit - nëse aplikojmë pa partner, çfarë duhet të shkruajmë, apo mund të shënojmë N/A?	Nëse aplikoni pa partnerë pjesa e partneritetit shënohet me N/A.
15.	Po ashtu, për pikën 28. Si do të siguroni transferimin e njohurive ndërmjet partnerëve në projekt? - në rast se nuk kemi partner, a mund të shënojmë N/A?	Nëse aplikoni pa partnerë pjesa e partneritetit nuk plotësohet.
16.	Tek lloji i kostos 1. Burimet Njerëzore, ku përfshihen 1.1 Pagat dhe 1.2 Kontratat e shërbimeve - a kufizohet shuma 30% vetëm për nën-kategorinë 1.1 Pagat, apo për totalin e grupit 1. Burimet Njerëzore?	Jo, nuk kufizohet. (Megjithatë komisioni vlerësues e mban të drejtën e rishikimit të buxhetit).
17.	Në udhëzues janë përmendur si shpenzime të pranueshme edhe shpenzimet e udhëtimit dhe	Po, deri në 5%.

	kostot e derivateve. A nënkuptohen kostot e derivateve si pjesë e shpenzimeve për transport?	
18.	A janë të pranueshme shpenzimet për qiranë e sallave ku mbahen aktivitetet e projektit?	Po.
19.	A pranohen faturat me TVSH për mbulimin e shpenzimeve?	Paguhet totali i faturës duke e përfshirë TVSH.
20.	A pranohen pagesat me para të gatshme (cash) nën shumën 200 euro, nëse shoqërohen me faturë të vlefshme?	Po, deri në vlerën 300 euro por që bashkëngjitet fatura e rregullt, kuponi fiskal dhe dëshmia e Mandat Pagesës e nënshkruar nga dy palët.